REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

ZYRA E BASHKËQEVERISJES DHE PERFORMANCËS

Nr. 2485 prot Maliq më 21/04/2026

Lënda: Kthim përgjigje.

Drejtuar: [redacted]

Adresa Rr. ''Nikolla Jorgo'' Kulla 8.Ap,8 Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, të paraqitur nëpërmjet postës elektronike, pranë Bashkisë Maliq ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është trajtuar dhe është kthyer përgjigje .

Gjithashtu, ju informojmë se Këshilli Bashkiak ka hartuar rregulloren përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të akteve dhe standardeve ndërkombëtare, bashkëngjitur gjeni dhe linkun në të cilin mund të keni qasje në çdo kohë dhe që është I publikuar ne Web-in e Bashkisë Maliq, https://bashkiamaliq.gov.al/keshilli-bashkiak/ Kuadri rregullator I këshillit NJVV, pika 4.

Ju faleminderitpërbashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

BIRN
BALKAN INVESTIGATIVE REPORTING NETWORK | ALBANIA

Rr. "Nikolla Jorga" | web: birn.eu.com
Kulla 8. Ap. 8 | E-mail: office.albania@birn.eu.com
Tirane, 1001
Albania

Tiranë: 14/04/2026

KËRKESË

KËRKUES: [redacted] **BIRN Albania**

DREJTUAR: **Bashkia Maliq**

OBJEKTI: **Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit**

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 119 dt. 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", neni 3
Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi te Drejtat Civile dhe Politike,

Të nderuar,

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkojmë vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe informacionit në lidhje me transparencën dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak.

Konkretisht, kërkojmë informacion mbi pikat e mëposhtme:

- **A ka miratuar Këshilli Bashkiak një rregullore specifike për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median?**
- **Nëse po, ju lutemi ta vendosni këtë rregullore në dispozicion në mënyrë elektronike, duke specifikuar gjithashtu numrin dhe datën e vendimit me të cilin është miratuar.**

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të përgjigjes suaj.

Përgjigja dhe dokumentet mund të dërgohen me postë elektronike në adresën **v[redacted]2@gmail.com**, **[redacted]@birn.eu.com** ose në rast se është e nevojshme me postë në adresën Rr. "Nikolla Jorgo" Kulla 8. Ap. 8, Tiranë, 1001 Albania.

Kjo kërkesë bazohet në ligjin e sipërpërmendur, i cili shprehet: *"Kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet."* Duke u bazuar në ligjin nr. 119, "Për të drejtën e informimit", këto informacione vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë specifike dhe të arsyetuar.

Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni në kontaktet e mëposhtme.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

[redacted]